



Republika e Kosovës – Republic of Kosova
Komuna Hani i Elezit- Municipality of Elez Han

05/ 2120 /2021
22.03.2021

Në bazë të Ligjit për Zyrtarët Publikë Nr.06/L-114, Kapitulli V neni 67 dhe 68 ,Ligjit të Punës Nr.03/L-212 neni 8,Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës Nr.03/L-068 neni 5, Ligjit për Arsim Parauniversitar Nr.04/L-032 neni 20 dhe 35 , Udhëzimit Administrativ nr.151/2020 Për Detyrat dhe Përgjegjësit e Drejtorit dhe të Zëvendës Drejtorit të Institucionit Publik Edukativo-Arsimor dhe Aftësues Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Procedurat e Zgjedhjes dhe Emërimit, Përfundimit të Kontratës dhe Emërimit të Përkohshëm, Drejtoria për Arsimit, Kulturë, Rini dhe Sport në komunën e Hanit të Elezit shpallë:

K O N K U R S **PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË LIRË TË PUNËS**

I.Titulli i vendit të punës: **Drejtor/esh në Institucionin Parashkollor (IP)**

Institucioni: **Komuna Hani Elezit**

Departamenti/Drejtoria: **Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport**

Lloji i pozitës: **Jo karrierës**

Numri i Pozitave: **një (1)**

Titulli i mbikëqyrësit: **Drejtori i Arsimit**

Grada/Koeficienti: **A-7.8**

Orët e punës: **40**

Kohëzgjatja e emërimit: **4 vite, (me mundësi vazhdimi)**

Qëllimi i vendit të punës:

Menaxhimi, organizimi dhe mbikëqyrja e procesit arsimor në institucionin edukativo arsimor.

Detyrat Kryesore:

- Përgjegjësi ekzekutive në menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm të institucionit;
- Përgatitjen e planit vjetor, planit zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor dhe raportet vjetore të punës;
- Përdorimin efikas dhe efektiv të sistemit për menaxhimin e informatave në arsim dhe respektimin e kodeve të këtij sistemi, procedurave të sigurimit dhe afateve të përcaktuar për përditësimin e të dhënave të nevojshme gjatë vitit shkollorë;
- Detyrat e caktuara për zgjedhjen e mësimitdhënësve, vlersimin, disiplinën në institucionin edukativo-arsimor dhe qështjet tjera që kanë të bëjnë me mësimitdhënësit dhe puntorët tjerë të arsimit;
- Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kurrikulës;
- Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e punës së aktiveve dhe bashkëpunorve profesional të institucionit edukativo-arsimor, si dhe mekanizmave tjerë, të institucionit arsimor që kanë rol në vlersimin e përformancës së institucionit dhe menagjimin e cilësisë së punës së institucionit;

- Bashkëpunon me Këshillin Drejtues të institucionit edukativo-arsimor(KDSH), Këshillin e Prindërve,Këshillin e Arsimitarve, Këshillin e Nxënësve dhe komunitetin e institucionit edukativo-arsimor;
- Raporton së paku dy herë në vitë para KDSH-së;
- Siguron ambient të sigurtë dhe përkrahës për fëmijët/nxënësit në institucionin edukativo-arsimor, duke përfshirë edhe caktimin dhe aplikimin e masave disiplinore ndaj nxënësve, sipas legjislacionit në fuqi;
- Ruajtjen e dokumenteve dhe të dhënave, siq parashihet nga komuna apo Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH);
- Çështjet e tjera që rregullohen përmes ligjit për arsin parauniversitar,akteve nenligjore të miratuara nga MASH dhe obligimet që dalin nga rregullorja e komunës për arsim;

Kushtet e pjesmarrjes në rekrutim:

Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;

Të kenë të kryer arsimin universitar, nivelet e kualifikimit që i plotësojnë kushtet sipas normativit profesional për arsim të përgjithëm dhe normativit për arsim profesional në fuqi:

-Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim,(kualifikimin prej 300 ECTS së paku 5 vite të shkollimit universitar);

-Master arsimor(kualifikimi prej 300 ECTS 5 vite të shkollimit universitar);

-Katërvjeçar(kualifikimi prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar);

-Bachelor katërvjeçar (kualifikimi prej 240 ECTS/ 4 vite të shkollimit universitar);

Të kenë licencë të rregullt të mesimdhënësit sipas udhëzimit për licencim të mesimdhënësve;

Të ketë të përfunduar me sukses një program kualifikimi profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovës,të aprovuar nga MASH, sipas rekomandimit të KSHLM;

Të ketë përvojë pune në procesin edukativo-arsimor sipas udhëzimeve të përcaktuara në katalogun e punës;

Katër (4) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor;

Dokumentet e nevojshme:

- ✓ Diplomën e fakultetit të kryer për nivelin përkatës të kualifikimit (kopje të vërtetuara);
- ✓ Certifikatën për kryerjen me sukses të programit të trajnimit për udhëheqje,administrim ose menaxhim në arsim,të bazuar në standarde e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë;
- ✓ Kandidati/ja që ka përfunduar programin universitar Master për udhëheqje,administrim ose menaxhim në arsim,në mungesë të certifikatës së trajnimit për udhëheqje në arsim,ofron dëshminë e diplomës Master në këtë fushë të studimeeve;
- ✓ Kopjen e dokumentit të identitetit (ID);
- ✓ Certifikatën shëndetësore të lëshuar në gjashtë muajt e fundit nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
- ✓ Dëshminë se nuk është nën hetime;
- ✓ Dëshminë për përvojën e punës në procesin edukativo-arsimor;
- ✓ Deklaratën në betim që vërteton se në tri vitet e fundit kandidati/ja nuk ka qenë në asnjë funksion udhëheqës në strukturat e partive politike;

✓ Portfolio profesionale duhet të përmbajë;

1. Biografinë e shkurtër;

2. Konceptin e Planit Zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor, bazuar në pesë fushat e cilësisë së performancës së shkollës (5- 10 faqe). Koncepti duhet të ketë 5-10 faqe tekst (minimum një faqe për një fushë të cilësisë) me hapësirë 1.5, fonti i shkronjave 12, Arial). Koncepti i PZH është pjesë përbërse e intervistës që realizohet nga komisioni përzgjedhës;

3. Certifikata që dëshmojnë përfundimin e programeve të zhvillimit profesional në fushën e administrimit, menagjimit dhe udhëheqjes, si dhe dëshmitë e tjera që elaborojnë përfundimin dhe realizimin e pjesëve të programit dhe demonstrojnë shkathtësitë e fituara;

4. Certifikatat që dëshmojnë përfundimin e suksesshëm të programeve të zhvillimit profesional të mësimdhënësve si dëshmi tjera rreth realizimit të atyre programeve;

5. Letër motivuese për pozitën që aplikon;

6. Dëshmi për aktivitete tjera në proceset e zhvillimit të arsimit (zhvillimi i kurrikulave, udhëheqja e programeve të zhvillimit profesional, pjesëmarrja dhe kontributi në konferenca etj.)

7. Dëshmi nga përvoja paraprake në menagjim (shembuj të projektve, shembuj të shkrimeve nga fusha e menagjimit, shembuj të plane për zhvillimin e institucionit edukativo-arsimor që janë zhvilluar dhe /apo impementuar me udhëheqjen apo kontributin tuaj konkret);

8. Dëshmi nga përvoja paraprake në mësimdhënie (shembuj të planeve të mësimi, shembuj të projektve, kopje të punimeve, mirenjohje etj);

9. Letër referencë me përmbajtje dëshmuese për punën dhe angazhimet paraprake nga një institucion publik – kredibil drejtëpërdrejt e lidhur me punën e kandidatit dhe për konkursin përkatës (si Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, DKA, Këshilli Drejtues i Institucionit Edukativ-Arsimor, punëdhënësi paraprak, Institucionet e Arsimit të lartë dhe individë me të cilët ka punuar ngushtë në programe dhe projekte të ndryshme për arsim).

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data 21.04.2021 deri 05.05.2021 (16:00).

Të gjithë kandidatët e interesuar aplikacionin e punësimit e marrin pranë Qendrës për Shërbime me Qytetarë në Han të Elezit kati I parë dhe të plotësuar e dorëzojnë në të njëjtin vend. Dokumentacioni I kandidatëve të cilët nuk I plotësojnë kushtet e konkursit nuk do tëshqyrtohet, ndërsa në intervistë do të ftohen vetëm kandidatët nga lista e ngushtë.

Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet jashtë Shtetit të Republikës së Kosovës si dhe në për kolegjet private Brenda Republikës së Kosovës, e që konkurrojnë për këto pozita, duhen që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në pajtim me udhëzimin administrativ, nr.12/2018 të datës 10.09.2018, në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kusht të konkursit.

Konkursi dhe rezultatet shpallne në linkun: <https://konkursi.rks-gov.net/> dhe në tabelën e shpalljes.

Drejtori për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport
Menduh Vlasi

